REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAĐANA
Sh. U. 02 Nr. Br. 18971
Nr. i faq. Br. str. 3 Data: Datum: 20/06
KAMENICË/A 2022

MARËVESHJE MIRËKUPTIMI
mes
KOMUNËS SE KAMENICËS
DHE
OJQ-SË DARDANAPRESS

Organizata Jo-Qeveritare DARDANAPRESS e përfaqësuar nga **Sherafedin Vranja,** Drejtor Ekzekutive/Menaxher i Projektit

Zyra e Kryetarit te Komunës, Komuna e Kamenicës, më poshtë si 'KK' të përfaqësuara nga **Kadri Rahimaj** , Kryetar i Komunës, bashkërisht si 'Palët', dhe individualisht si 'Pala';

Kuvendi Komunal , Komuna e Kamenicës, e përfaqësuar nga Kryesuesi **Liridon Kastrati** , Kryesues i Kuvendit Komunal, bashkërisht si 'Palët', dhe individualisht si 'Pala';

Dispozitat e Përgjithshme

Programi i KCSF-së për mbështetje të shoqërisë civile "EJA Kosovë" ka lëshuar një ftesë për projekt propozime për organizatat shoqërisë civile, ku Dardanapress është përzgjedhur për implementimin e projektit të mëposhtëm.

1. Kamenicë
2. OJQ- Dardanapress paraqiti një projekt propozim të titulluar **"Ngritja e transparencës Komunale dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje"**
3. Kohëzgjatja e projektit është 9 muaj (qershor 2022 – shkurt 2023) .

Obligimet e OJQ-së DARDANAPRESS/KK-së

4. Komuna do të lejoj përfaqësuesit e OJQ-së DARDANAPRESS të marrin pjese, dhe të evokojnë në punën e Komunës lidhur me rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse. Po ashtu do të marrë pjesë në mbledhje të Kuvendit Komunal , Komitetit për Politike dhe Financa, Komitetin për Komunitete si dhe të takoj Drejtorë të Drejtorive si dhe zyrtare tjerë në komunë.

5. Aktivitetet e projektit do të zgjasin për 9 muaj sa është edhe kohëzgjatja e projektit të titulluar **"Ngritja e transparencës Komunale dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje"** që do të financohet nga **programi i KCSF-së për mbështetje të shoqërisë civile "EJA Kosovë ",bashkëfinancuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) Suedia dhe Qeveria e Dukatit të Madh te Luksemburgut** dhe të implementuar nga OJQ Dardanapress

6. Komuna pajtohet të ofroj informata lidhur me rritjen e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimmarrëse dhe informata tjera që janë të nevojshme në kuadër të implementimit të projektit në pajtim me ligjet në fuqi të Republikës së Kosovës.

7. Komuna pajtohet të liroj nga detyrime e punës zyrtarë komunal që do të jenë pjesë e aktiviteteve të projektit (punëtorive, trajnime, takimeve joformale me qytetarë, dhe tryezave të rrumbullakëta kurse Dardanapress është e obliguar të ofroj me kohë (së paku 3 ditë) ftesa dhe agjenda lidhur me takime.

8. Kryesuesi i Kuvendit Komunal ti përgjigjet pozitivisht ftesave për trajnime,takime,tryezave së bashku me anëtarët e Kuvendit, anëtarëve të Komitetit për Politik dhe Financa, anëtarëve të Komitetit për Komunitete.

9. Kryesuesi së bashku me sekretarin e Kuvendit ti dërgojë Ftesat-Agjendën në emalin zyrtarë të Dardanapress-it, dardanapress@hotmail.com të mbajtjes të mbledhjeve të Kuvendit Komunal Komitetit për Politik dhe Financa dhe Komitetit për Komunitete.

10. Kuvendi Komunal , Komuna e Kamenicës, nuk kanë asnjë implikim buxhetor gjatë realizimit të projektit.

11. Menaxheri i Projektit, monitoruesi si dhe personeli tjetër i OJQ-së, është i obliguar që të gjitha të gjeturat gjatë evokimit të mos i shpërndaj palëve të treta por ti ruaj dhe ti përdor për shërbim të projektit ku raporti i monitorimit do të bëhet publik sipas planit të aktiviteteve.

Dispozitat e ndryshme

12. **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:** Çdo mosmarrëveshje, polemikë ose ankesë që del nga ose në lidhje me Marrëveshjen e Mirëkuptimit,ose prishje, anulim të pavlefshmërisë duhet të rregullohet përmes negociatave dhe konsultimeve mirëdashëse me besim të mirë mes Palëve. Në rast të dështimit në rregullimin e çështjes së këtillë, duhet të zbatohen kushtet brenda Rregulloreve dhe Ligjeve të Kosovës në fuqi.

13. **Ndryshimet:** Asnjë ndryshim në këtë Marrëveshje ose ndonjë dorëheqje nga ndonjë dispozitë nuk do të jetë valide përveç nëse reciprokisht merren vesh me shkrim dhe e njëjta të nënshkruhet nga përfaqësues të autorizuar të Palëve.

14. **Hyrja në Fuqi:** Kjo Marrëveshje hynë në fuqi pas nënshkrimit të saj nga Palët.

15. **Njoftimi**: Çdo njoftim i dhënë në lidhje me këtë Marrëveshje duhet të jetë në gjuhën Shqipe dhe duhet të jepet në mënyrë valide nga njëra palë në tjetrën, ose të dërgohet përmes letrës së regjistruar, emalit te përfaqësuesit siç është theksuar në Hyrjen e kësaj Marrëveshje.

16. **Gjuha:** Marrëveshje është bërë në tri (3) kopje të njëjta në gjuhën Shqipe, secila prej tyre do të mbahet nga secila palë

Nënshkruar me ---------- në Kamenicë

Në emër të Komunës	Në emër të OJQ-Dardanapress	Në emër të Kuvendit Komunal
Kryetari i Komunës Kadri Rahimaj	Drejtori Ekzekutiv/Projekt Menaxheri Sherafedin Vranja	Kryesuesi i Kuvendit Komunal Liridon Kastrati

Bashkëfinancuar nga:

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

Sweden
Sverige

LUXEMBOURG
AID & DEVELOPMENT